



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E VËZHguesve AFATSHKURTËR DHE PËRKTHYESVE TË KONGRESIT TË AUTORITETEVE LOKALE DHE RAJONALE TË KËSHILLIT TË EVROPËS NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 21.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Miratimi i vëzhguesve afatshkurtër dhe përkthyesve nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 6, pika 2, 4, 5, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr.13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave"



Nr. 844 i Vendimit

Data 21 .06.2019

Ora 10 .⁰⁰ e Vendimit

Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër dhe përkthyesve të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor, 2019

V È R E N

Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës është një institucion përgjegjës për forcimin e demokracisë lokale dhe rajonale në 47 shtetet anëtare dhe vlerësimin e zbatimit të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale. Si zëri i bashkive dhe rajoneve të Evropës, ai punon për të nxitur konsultimin dhe dialogun politik midis qeverive kombëtare dhe autoriteteve lokale dhe rajonale, nëpërmjet bashkëpunimit me Komitetin e Ministrave të Këshillit të Evropës.

Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës ka marrë pjesë në misione vëzhguese për zgjedhjet lokale në 47 vende anëtare të Këshillit të Evropës dhe, që nga viti 1990 ka kryer pothuajse 100 misione të vëzhgimit të zgjedhjeve deri tani. Vëzhgimi i zgjedhjeve lokale është një nga prioritetet e veprimtarisë të Kongresit. Kjo veprimtari plotëson monitorimin politik të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale, e cila përbën themelin e demokracisë lokale në Evropë.

Kjo organizatë ka paraqitur kërkesën e saj bashkë me dokumentacionin mbështetës pranë KQZ për akreditimin e 19 (nëntëmbëdhjetë) vëzhguesve afatshkurtër dhe 8 (tetë) përkthyesve. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vëren se ai është brenda kushteve dhe kërkesave të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 6 , pika 2, 4, 5 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës për akreditimin e 19 (nëntëmbëdhjetë) vëzhguesve afatshkurtër dhe 8 (tetë) përkthyesve, për vëzhgimin e procesit zgjedhor për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor



Nr. 844 i Vendimit

Data 21 .06.2019

Ora 10 .⁰⁰ e Vendimit

Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër dhe përkthyesve të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor, 2019

2019, sipas listës të përcaktuar në lidhjen Nr.02 dhe lidhjen Nr.03, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare



Nr. 844 i Vendimit

Data 21 .06.2019

Ora 10 .⁰⁰ e Vendimit

Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër dhe përkthyesve të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor, 2019